



Prishtinë, 28.12.2022

PËRGJIGJE NË KOMENTET E KOSTT

Përmbledhje

Pas raportit fillestar *Raporti i Monitorimit në lidhje me Blerjet e Energjisë Elektrike, Pagesat dhe Nominimet*, i licencuari ka pasur mundësi të paraqes komentet për një periudhë dy javore.

Gjatë periudhës 2 javore, ZRRE ka pranuar komente nga KOSTT, të cilat i ka analizuar me kujdes dhe i ka paraqitur përmes këtij dokumenti propozimet përfundimtare lidhur me monitorimin e blerjeve të energjisë elektrike pagesat dhe nominimet për operatorin e sistemit të transmetimit (KOSTT).

ZRRE ka dhënë përgjigjet në komentet e palës sipas grupimit të çështjeve të trajtuara.

Komentet e KOSTT si Përgjigje mbi raportin e monitorimit të ZRRE-së

Faturimi dhe pagesat ndërmjet të Licencuarve

Të gjeturat e ZRRE-së:

- 1. Sa i përket borxhit të akumuluar të palëve tregtare ndaj KOSTT, mund të konkludohet se KOSTT nuk ka shfrytëzuar të gjithë mekanizmat ligjor të paraparë në marrëveshjet me palët për të pamundësuar grumbullimin e borxhit të palëve ndaj tij.*
- 2. KOSTT nuk ka zbatuar garancionin bankar për palët përgjegjëse për balancim sipas Nenit 8 të Rregullave të tregut, si dhe sipas Procedurës së Rregullave të Tregut për Garancion Financiar.*

Përgjigje e KOSTT

- 1. Bazuar në veprimet e ndërmarra nga KOSTT gjatë tërë periudhës në fjalë, KOSTT i ka shfrytëzuar të gjithë mekanizmat ligjor dhe procedural të paraparë me legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet me palët, por për shkak të gjendjes emergjente në sektorin e energjisë elektrike si dhe me qëllim të ruajtjes së stabilitetit të sektorit KOSTT këta mekanizma i ka aktivizuar në afate më të zgjatura kohore.*

KOSTT në arsyetimin e tyre ka sqaruar kronologjinë e borxhit të akumuluar nga palët, si dhe takimet e shumta bilaterale mes tyre, përfshirë edhe njoftimin që i ka bërë ZRRE-së dhe Ministrisë së Ekonomisë lidhur me vonesat në inkasim të pagesave. KOSTT, poashtu sqaron se për shkak mos ngarkimit me kosto shtese në sektor deri në muajin Maj 2022 nuk kanë ndërmarrë masa ligjore (procedura përmbartimore), por meqenëse problemet vazhduan edhe me tutje duke filluar nga muaji Maj, KOSTT vendosi të filloj me procedura përmbartimore duke filluar me faturat e pa paguara për jo balance të cilat ishin në vlerën prej 29.4 milion euro e pastaj duke vazhduar me procedura përmbartimore edhe



për borxhet tjera nga tarifa në muajin gusht 2022 përafërsisht në vlerën prej 31.7 milion e cila ka përfshirë faturat deri në muajin prill 2022. KOSTT sqaron se tani janë në proces të fillimit të procedurës përbarimore edhe të pjesës tjetër të borxheve të mbetura.

2. KOSTT konsideron se e gjetura që garancioni financiar për palët përgjegjëse për balancë nuk është zbatuar nga ana e KOSTT nuk qëndron, pasi që ka ekzistuar një dakordim për mos zbatimin e garancionit financiar i arritur në takimet e përbashkëta ndërmjet KOSTT dhe ZRRE nga të cilët kërkohet koordinim i ngushtë për fillimin e zbatimit të tij. Ndër arsyt kryesore kanë qenë shmangia e rritjes së çmimit të energjisë për konsumatorët si rezultat i implikimit të vlerave shumë të mëdha minimale të llogaritura të garancionit financiar për Palë, si dhe rrezikut të ulët të mos pagesës së obligimeve ndaj llogarisë balancuese pasi që shumica e palëve aktive në treg kanë qenë në pronësi publike ose me obligime të shërbimit publik. KOSTT ka bërë përpjekje për fillimin e zbatimit të garancionit financiar ku ka përgatitur një model për llogaritjen e nivelit minimal të garancionit financiar të cilën e ka ndarë me ZRRE-në, mirëpo ka hasur në vështirësi për shkak mangësive dhe kufizimeve të Procedurës së Garancionit Financiar që institucioni bankar ofruet i garancionit të ketë vlerësim ndërkombëtar [B+] dhe pamundësisë së shumicës së bankave në Kosovë që të sigurojnë si të vetme vlera të mëdha të garancionit financiar. Këto vështirësi janë paraqitur në ZRRE ku është hasur në mirëkuptim dhe KOSTT ka filluar amendamentimin e procedurës që do të dorëzohet për miratim në ZRRE në mënyrë që të mundësohet sa më parë zbatimi i garancionit financiar në koordinim të ngushtë me ZRRE dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KOSTT në arsyetimin e tyre ka sqaruar se koha e implementimit të garancionit financiar ndërlidhet me fillimin e implementimit të mekanizmit balancues në KOSTT nga qershori 2017, dhe se që nga fillimi i zbatimit të Mekanizmit Balancues të gjitha obligimet ndaj KOSTT janë shlyer pa ndonjë problem. KOSTT, poashtu pretendon se ka pasur një dakordim mes ZRRE dhe KOSTT për të mos iniciuar zbatimin e garancionit bankar për t'iu shmangur rritjes së çmimit të energjisë për konsumatorët që do të rezultonte nga implikimi i vlerave shumë të mëdha minimale të llogaritura të garancionit financiar për Palët përgjegjëse për balancë si dhe rreziku i ulët i mos pagesës së obligimeve ndaj llogarisë balancuese pasi që shumica e palëve aktive në treg kanë qenë në pronësi publike ose me obligime të shërbimit publik.

Përgjigje e ZRRE-së

Lidhur me sqarimet e KOSTT për **të gjeturën 1**, ZRRE pajtohet se ka pasur vonesa për shkak të çmimeve të larta dhe gjendjes emergjente dhe kupton faktin që KOSTT nuk ka zbatuar menjëherë mekanizmat e paraparë me kontratë për të ruajtur stabilitetin e sektorit të energjisë, por, duhet theksuar se KOSTT në vazhdimësi ka filluar vitin me borxhe të akumuluar të palëve ndaj tij (vitin 2021 ka filluar me borxhe 11.3 mil EURO). Në vitin 2021 deri në shpalljen e gjendjes emergjente në dhjetor 2021, borxhi i akumuluar i palëve deri në fund të nëntorit 2021 ishte 24.8 mil EURO, prej të cilave KEK-4.1 mil EUR, KESCO-16.4 mil EURO dhe KEDS -4.2 mil EURO. Kur kësaj i shtohet borxhi i muajit dhjetor 2021, gjithnjë bazuar në raportet e dërguara nga KOSTT, atëherë borxhi në fund të vitit ishte 53.5 mil EURO të cilat janë bartur në vitin 2022, respektivisht KEK -1.65 Mil EURO, KESCO -39.18 mil EURO dhe KEDS – 12.7 mil EURO.



Borxhi total i akumuluar i palëve ndaj KOSTT, deri në muajin Maj 2022 ku KOSTT kishte filluar të zbatoj kushtet e marrëveshjes, përfshirë edhe përmbartimin, kishte arritur vlerën -61.84 mil EURO, prej të cilave KEK – 2.08 mil EURO, KESCO -38.48 mil EURO dhe KEDS -21.28 mil EURO.

ZRRE vlerëson se moszbatimi me kohë i dispozitave përmbartimore sipas kontratës mes palëve ka shkaktuar probleme financiare dhe ka rrezikuar stabilitetin financiar të KOSTT, e cila si kompani publike do duhej të reagoje me kohë.

Lidhur me sqarimet e KOSTT për të gjeturën 2, ZRRE vlerëson se nuk ka pasur ndonjë dakordim mes tyre dhe KOSTT do duhej ta zbatonte me kohë Procedurën e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiarë, sepse në këtë mënyrë do të ndikonte që borxhi i grumbulluar për jobalance të mos ishte aq i lartë. Duhet theksuar se ky borxh në fund të vitit 2021 kishte vlerën 39.2 mil EURO, prej të cilave KEK 0.17 mil EURO, KESCO 26.9 mil EURO dhe KEDS 12.12 mil EURO.

Sa i përket kërkesës së KOSTT për përcaktimin e Çmimit Sigurues të Jobalancit (par. 3.1.2 dhe par. 3.1.3), përqindjes minimale të jobalanceve negative të energjisë gjatë kalkulimit të nivelit minimal të garancionit financiar për çdo Palë Tregtare (par. 3.2.1) sipas Procedurës së Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar, ZRRE ka dhënë komentet e veta dhe pajtueshmërinë për kalkulimin e vlerës së këtij garancioni.

Me amendamentimin e Rregullave të Tregut në vitin 2018, do të duhej të amendamentoheshin edhe procedurat të cilat rrjedhin nga Rregullat e Tregut, në mesin e të cilave është edhe Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiarë.

Kërkesa e KOSTT për amendamentimin e Procedurës së Rregullave të Tregut për Garancionin Financiarë ka ardhur vetëm pas kërkesës eksplicite të ZRRE-së për aplikimin e këtij garancioni, me ç' rast KOSTT ka vërejtur edhe kërkesën që institucioni bankar ofruer i garancionit duhet të ketë vlerësim ndërkombëtar [B+] dhe pamundësinë së shumicës së bankave në Kosovë që të sigurojnë si të vetme vlera të mëdha të garancionit financiar.

Prandaj ZRRE vlerëson se me mos zbatimin e garancionit financiar, KOSTT nuk është në pajtueshmëri me Rregullat e tregut Neni 8 dhe me Procedurën e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar.

Blerjet e energjisë nga KOSTT për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit

Të gjeturat e ZRRE-së:

1. KOSTT, deri në prill 2022 ka nënshkruar Kontrata Kornizë dhe ka tregtuar me ndërmarrjet të cilat nuk janë të licencuara në Kosovë, respektivisht nuk i njihet licenca e lëshuar nga vendet përkatëse, sipas parimit të reciprocitetit. Bazuar në këtë të gjetur, KOSTT nuk ka vepruar në pajtueshmëri me neni 28, par.1 dhe par. 2 dhe neni 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, neni 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, neni 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, neni 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike.



Përgjigje e KOSTT

1. KOSTT nuk pajtohet me të gjeturën e ZRRE-së dhe konsideron se nuk ka bërë shkelje duke u bazuar në faktin se Ligji për Energjinë Elektrike (Neni 24, Neni 4) i jep të drejtë KOSTT që të blejë energji nga ndërmarrjet e tjera të energjisë të Palëve Kontraktuese të Energjisë me qëllim të arritjes së konkurrencës dhe plotësimit të kërkesës për energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin transmetimit. Gjithashtu referimi i ZRRE-së se KOSTT nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Rregullat e Tregut nuk qëndron sepse nenet dhe paragrafët e cituar nga Rregullat e Tregut përcaktojnë kushtet për aderim në Rregullat e Tregut me Funksione Pjesëmarrëse të caktuara në Rregullat e Tregut e jo kushtet për lidhjen e Marrëveshjes Kornizë për Blerjen e Humbjeve.

KOSTT në arsyetimin e tyre ka sqaruar përgjegjësit e tij të dhëna me legjislacionin primar dhe licencën e tij lidhur me prokurimin e energjisë për humbjet në rrjetin e transmetimit, balancimin e sistemit dhe ofrimin e shërbimeve ndihmëse, dhe ndër tjera pretendon se: duke pasur parasysh faktin që me fillimin e operimit si zone e pavarur me 14 dhjetor 2020 ka pasur vetëm dy pale të licencuara nga ZRRE dhe kjo pasqyron mungesë të konkurrencës si dhe bazuar në Nenin 24 par. 4 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L – 085) ku përcaktohet: *...Me qëllim të arritjes së konkurrencës në tregun e energjisë dhe me synim të plotësimit të kërkesës për energji elektrike në Kosovë, në kuadër të dispozitave të këtij Ligji dhe ligjeve tjera në fuqi, pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike mund të lidhin kontrata për shitjen apo blerjen e energjisë elektrike me:*

4.1. ndërmarrje tjera të energjisë dhe me konsumatorë brenda Kosovës;

4.2. ndërmarrje tjera të energjisë elektrike dhe konsumatorët në sistemet tjera të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë sa kohë që furnizuesit i zbatojnë rregullat e aplikueshme të tregtimit të energjisë së balancimit.”

ka lidhur kontrata kornizë me ndërmarrje të energjisë si brenda vendit ashtu edhe me ndërmarrje tjera të energjisë elektrike të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë të cilat kanë qenë të licencuara në vendet e tyre.

KOSTT, poashtu sqaron se Kontratat kornizë nuk ju kanë mundësuar këtyre palëve ushtrimin e ndonjërit nga Funksionet Pjesëmarrëse në Rregullat e Tregut por vetëm shitjen e energjisë tek KOSTT për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit i cili transaksion është kryer në kufi të zonës ofertuese të Kosovës ashtu si parashihet me Marrëveshjet për Skedulim të KOSTT me TSO-të e tjera, dhe se menjëherë ka ndërprerë tregtimin me këto ndërmarrje pas reagimit të ZRRE-së më datë 27 prill 2022.

Përgjigje e ZRRE-së

Lidhur me sqarimet e KOSTT, ZRRE pajtohet se fillimisht ka pasur numër të vogël të të licencuarve, por ky numër është rritur vazhdimisht dhe ndërkohë ka pasur konkurrencë të mjaftueshme sa i përket të licencuarve për tregtimin e energjisë elektrike.

ZRRE konsideron se nuk janë relevante arsyetimet e dhëna nga KOSTT lidhur me tregtimin e energjisë elektrike me tregtarë të pa licencuar në Kosovë, apo me njohje reciproke sipas kërkesave ligjore.



Prandaj ZRRE rikujton KOSTT-in se bazuar në legjislacionin në fuqi, aktiviteti i furnizimit dhe tregtimit me energji elektrike mund të ushtrohen vetëm me Licencë të lëshuar nga ZRRE për subjektet juridike që janë të regjistruara në Kosovë, duke përfshirë edhe mundësinë që sipas parimit të reciprocitetit këto aktivitete të lejohen edhe pa Licencat e ZRRE-së për tregtarët të cilët kanë licenca në shtetet e tyre, e të cilat mund të njihen në Kosovë vetëm pasi të plotësohen kushtet e përcaktuara në Rregullën për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës nr 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Gjithashtu, KOSTT, në dhjetor të vitit 2020, pas nënshkrimit të marrëveshjes së kyçjes me ENTSO-E, i'u është drejtuar me email të gjitha palëve tregtare që operojnë në Kosovë, duke kërkuar nga ta që të licencohen konform legjislacionit në fuqi.

Nga këto që u thanë më lartë, ZRRE rithekson se KOSTT nuk ka ofruar argumente relevante për t'i kundërshtuar të gjeturat në Raportin e ZRRE-së, andaj "KOSTT nuk ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 28, par.1 dhe par. 2 dhe nenin 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, nenin 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, nenin 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, nenin 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike".

Blerjet e Energjisë nga KOSTT për mbulim të humbjeve në veri të vendit

Të gjeturat e ZRRE-së:

1. KOSTT ka blerë energji elektrike nga KEK për mbulimin e humbjeve në Veri të vendit, nën kushtet e marrëveshjes për mbulimin e humbjeve të sistemit. Blerja e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Veri nga KEK, pa procedure tenderuese, bie në kundërshtim me procedurën e tregtimit të energjisë elektrike, pasi që në procedurë përcaktohet që tregtimi i energjisë elektrike duhet t'i nënshtrohet tregut të lirë dhe konkurrues.

2. KOSTT ka nënshkruar Kontrata Kornizë me ndërmarrjet të cilat nuk kanë qenë të licencuara në Kosovë, respektivisht nuk i njihet licenca e lëshuar nga vendet përkatëse, sipas parimit të reciprocitetit. Bazuar në këtë të gjetur, KOSTT nuk ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 28, par.1 dhe par. 2 dhe neni 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, neni 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, neni 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, neni 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike.

Përgjigje e KOSTT

1. E gjetura që KOSTT ka blerë energji për humbjet në veri nga KEK pa procedurë tenderuese nuk qëndron sepse në dokumentin Përshkrimi i trajtimit të energjisë me shumicë dhe furnizim me shumicë të lëshuar nga ZRRE më 18 janar 2017, ZRRE rekomandon që energjia nga KEK duhet të alokohet ashtu që: "Pjesa e mbetur e energjisë së prodhuar nga KEK do të ofrohet në tregun me shumicë, ku do të përfshihen mbulimi proporcional i KOSTT dhe KEDS për humbjet në rrjetet përkatëse ashtu siç janë lejuar nga ZRRE, humbjet në veri të Kosovës dhe eksporti". Në secilin rast ku ka pasur vendim për mbulim të kostove për humbje në veri, KOSTT ka organizuar ankandet për blerjen e humbjeve në



mënyrë krejt transparente përmes platformës së dedikuar për blerje të humbjeve (platformë që i është prezantuar ZRRE-së sipas kërkesës së tyre).

KOSTT thekson se Neni 5 i Licencës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike obligon atë të sigurojë energji elektrike për të kompensuar humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar, po jo e paguar, nga konsumatorët e pjesës veriore të Kosovës, dhe se një gjë të tillë KOSTT e bënë duke shfrytëzuar linjat e dedikuara buxhetore apo nga ndonjë vendim, duke u bazuar në dokumentin e lëshuar nga ZRRE më 31.03.2017 Përshkrimi i trajtimit të energjisë me shumicë dhe furnizim për fazën tranzitore ku në pikën 5 sqarohet se: “Pjesa e mbetur e energjisë së prodhuar nga KEK do të ofrohet në tregun me shumicë, ku do të përfshihen mbulimi proporcional i KOSTT dhe KEDS për humbjet në rrjetet përkatëse ashtu sic janë lejuar nga ZRRE, humbjet në veri të Kosovës dhe eksporti” , si dhe bazuar në Procedurën për tregtim të energjisë së aprovuar nga ZRRE.

2. KOSTT nuk pajtohet me të gjeturën nga Raporti i Monitorimit i ZRRE për shkak se Ligji për Energjinë Elektrike (Neni 24, Neni 4) i jep të drejtë KOSTT që të blejë energji nga ndërmarrjet e tjera të energjisë të Palëve Kontraktuese të Energjisë me qëllim të arritjes së konkurrencës. Referimi i ZRRE-së se KOSTT nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Rregullat e Tregut nuk qëndron sepse nenet dhe paragrafët e cituat nga Rregullat e Tregut përcaktojnë kushtet për aderim në Rregullat e Tregut me Funksione Pjesëmarrëse të caktuara në Rregullat e Tregut e jo kushtet për lidhjen e Marrëveshjes Kornizë.

Përgjigje e ZRRE-së

Sa i përket të gjeturës 1, ZRRE sqaron se dokumenti Përshkrimi i trajtimit të energjisë me shumicë dhe furnizim me shumicë i lëshuar nga ZRRE më 18 janar 2017 ka qenë për një periudhë tranzitore, deri më 31 mars 2018, dhe për më tepër, pjesa që ka të bëjë me humbjet e sistemit, pas Aktvendimit të Gjykatës kompetente, nuk duhet të vlej dhe KOSTT nuk mund ta shfrytëzojë një marrëveshje për humbje të sistemit për të prokuruar energji për pjesën veriore të vendit.

Prandaj, ZRRE konsideron se tregtimi i energjisë elektrike mes KOSTT dhe KEK për energjinë e pafaturuar për pjesën veriore të Kosovës paraqet shkelje të Ligjit për energjinë elektrike, neni 22, paragrafi 2 dhe 3.

Sa i përket të gjeturës 2, ZRRE konsideron se nuk janë relevante arsyetimet e dhëna nga KOSTT lidhur me tregtimin e energjisë elektrike me tregtarë të pa licencuar në Kosovë, apo me njohje reciproke sipas kërkesave ligjore.

Prandaj, ZRRE rikujton KOSTT-in se bazuar në legjislacionin në fuqi, aktiviteti i furnizimit dhe tregtimit me energji elektrike mund të ushtrohen vetëm me Licencë të lëshuar nga ZRRE për subjektet juridike që janë të regjistruara në Kosovë, duke përfshirë edhe mundësinë që sipas parimit të reciprocitetit këto aktivitete të lejohen edhe pa Licencat e ZRRE-së për tregtarët të cilët kanë licenca në shtetet e tyre, e të cilat mund të njihen në Kosovë vetëm pasi të plotësohen kushtet e përcaktuara në Rregullën për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës nr 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.



Gjithashtu, KOSTT, në dhjetor të vitit 2020, pas nënshkrimit të marrëveshjes së kyçjes me ENTSO-E, i'u është drejtuar me email të gjitha palëve tregtare që operojnë në Kosovë, duke kërkuar nga ta që të licencohen konform legjislacionit në fuqi.

Nga këto që u thanë më lartë, ZRRE rithekson se KOSTT nuk ka ofruar argumente relevante për t'i kundërshtuar të gjeturat në Raportin e ZRRE-së, andaj "KOSTT nuk ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 28, par.1 dhe par. 2 dhe nenin 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, nenin 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, nenin 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, nenin 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike"

Devijimet e sistemit në raport me rrjetin interkonektiv

Të gjeturat e ZRRE-së:

1. Zbatimi i masës për reduktim të ngarkesës në muajin dhjetor 2021 nga ana e KOSTT është në pajtueshmëri me Vendimin e Qeverisë për shpalljen e gjendjes emergjente të datës 24.12.2021, përveç dy ditëve 22-24 dhjetor 2021, ku KOSTT ka qenë i obliguar të zbatoj të gjithë mekanizmat sipas nenit 2.5.1.1 të Kodit të balancit (masat e ndërmarra si importet, injektimet apo veprimet balancuese për të plotësuar kërkesën totale).

2. Sa i përket masave për reduktim të ngarkesës të vendosura nga KOSTT në muajin gusht 2022, pas deklarimit të KEDS dhe KESCO lidhur me importin e energjisë për nevojat e tyre dhe pas shpalljes së gjendjes emergjente në furnizim me energji, ZRRE ka analizuar kodet teknike të referuara nga KOSTT lidhur me rastet kur mund të konsiderohet pamjaftueshmëria e furnizimit, dhe vlerëson se Kodi i Balancit i jep të drejt KOSTT për të reduktuar ngarkesën, vetëm pasi ti ketë shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e paraparë në pikën 2.5.1.1 të Kodit të Balancit, duke përfshirë importet, injektimet, apo veprimet balancuese për të evituar shfaqjen e mungesës së furnizimit në sistem, apo pas nxjerrjes së vendimit për masat kufizuese të rekomanduara nga komiteti teknik, gjë që nuk kanë ndodhur as nga KOSTT e as nga ministria.

3. Shfrytëzimi i rezervës aFRR, e dedikuar për balancim të sistemit, për devijimet e shkaktuara nga humbjet e energjisë për pjesën veriore të vendit, bie në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës ku kërkohet që, deri në shpalljen e Aktgjykimit të formës së prerë, sipas Ligjit mbi Konfliktet Administrative, kosto e furnizimit me energji elektrike për katër komunat e veriut të Kosovës sipas Aktvendimit të Gjykatës nuk do të vazhdojë të mbulohet përmes tarifave të konsumatorëve fundor.

Përgjigje e KOSTT

1. & 2. KOSTT konsideron se gjatë periudhës kohore të cekur këtu, bazuar në raportimet pas operative, kemi vepruar në përputhje të plotë me legjislacionin dhe procedurat në fuqi, konkretisht Ligjin për Energji nr. 05/L-81 Neni 25, Udhëzimin Administrativ UA Nr.04/2017, Kodin e Balancit Neni 2.5.1.1, Kodin Operativ Neni 6.1.1 dhe 6.12.1 dhe Neni 2.5.1.1. Duhet theksuar se bazuar në Ligjin për Energji Elektrike neni 16 paragrafi 1.19. si dhe Kodin e Rrjetit, KOSTT është përgjegjës për balancimin e sistemit në kohë reale)

KOSTT thekson se gjatë periudhës në fjalë janë ballafaquar me rrethana ekstreme ku devijimet interkonektive si tërheqje nga rrjeti në disa raste kanë shkuar deri në 40% të konsumit nacional, dhe



për këtë arsye KOSTT ka marrë disa here ultimatum nga ENTSO-E për ti ndalur këto devijime sepse janë shkelje të kushteve të Marrëveshjes së Kyqjes me ENTSO-E. Prandaj KOSTT pretendon se duke qenë përgjegjës për balancim të sistemit në kohë reale, ka vepruar plotësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi, Ligjin për energji nr.05/L-081 Neni 25, Udhëzimin Administrativ UA Nr.04/2017, Kodin e Balancit Neni 2.5.1.1, Kodit Operativ Neni 6.1.1 dhe 6.12.1 dhe nenin 2.5.1.1. Për më tepër, në situatën e shpallur emergjente nga Qeveria e Kosovës, KOSTT e mban të drejtën e aplikimit të reduktimeve të konsumit bazuar në Udhëzimin Administrativ UA Nr.04/2017 Neni 4.5, Neni 5.4, Ligji për energji nr.05/L-081 Neni 25, kurse Ministria e Ekonomisë, pas aprovimit të rekomandimit të Komitetit Teknik Emergjent (KTE) nxjerr vendimin për implementimin e planit të masave kufizuese në furnizim, prandaj në kohë reale, deri në marrjen e këtij vendimi për aplikimin e masave kufizuese konform situatës së krijuar, KOSTT është përgjegjës për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për mbrojtjen e sistemit, në pajtim me ligjin për energji nr.05/L-081, neni 25 dhe Kodin e Rrjetit.

3. KOSTT nuk e ka shkelur Vendimin e Gjykatës sipas të cilit kostot e shkaktuara në veriun e Kosovës të mos mbulohen përmes tarifave të konsumatorve fundor pasi që në asnjë rast KOSTT nuk ka realizuar pagesën e aktivizimit të aFRR për devijimet e shkaktuara nga konsumi i veriut të Kosovës nga ndonjë vijë buxhetore e cila nuk ka qenë e dedikuar për mbulimin e kostove të furnizimit me energjinë elektrike për katër komunat e veriut nga Qeveria e Kosovës.

KOSTT, në përgjigjen e tij ka sqaruar në detaje kompleksitetin dhe funksionimin e rezervave rregulluese dhe deklaroi me përgjegjësi se *KOSTT ngarkon me obligime financiare vetëm palët tregtare që kane qenë në imbalance në atë periudhë kohore, saktësisht me pjesëmarrjen e tyre, e në asnjë mënyrë me kosto shtesë për pjesën e imbalanceve të ndonjë pale tjetër tregtare.*

Për më tepër, KOSTT nga aspekti komercial ka bërë ndarjen energjisë së imbalanceve të veriut nga imbalancec tjera dhe pagesa për këtë energji nuk është bërë nga asnjë fond përveç atij të dedikuar për këtë qëllim nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përgjigje e ZRRE-së

Sa i përket të gjeturës 1, ZRRE pajtohet me disa nga sqarimet e dhëna nga KOSTT lidhur me zbatimin e kodeve dhe me veprimet pas shpalljes së gjendjes emergjente, por KOSTT nuk ka ofruar argumente lidhur me zbatimin e masave kufizuese në furnizim me energji duke zbatuar reduktime për datat 22-24 dhjetor 2021, kur nuk ka qenë ende e shpallur gjendja emergjente. Për më tepër, sa i përket këtyre ditëve, KOSTT nuk ka dërguar dëshmi që ka zbatuar plotësisht Kodin e Balancit paragrafi 2.5.1.1. ku thuhet: *a) Kur ekzistojnë situata të tilla që e bëjnë të pamundur parandalimin e mungesës së energjisë, masat e ndërmarra si importet, injektimet apo veprimet balancuese nuk mund të plotësojnë kërkesën totale.*

Prandaj ZRRE konsideron se KOSTT ka bërë shkelje sepse nuk ka shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e paraparë me kodin e balancës, nenit 2.5.1.1, për të parandaluar shfaqjen e mungesës së energjisë (masat e ndërmarra si importet, injektimet apo veprimet balancuese nuk mund të plotësojnë kërkesën totale), por ka kaluar direkt në mekanizmin e fundit duke urdhëruar KEDS-in që të aplikoj reduktim të ngarkesës në rrjetin e shpërndarjes.

Sa i përket të gjeturës 2, ZRRE pajtohet me KOSTT lidhur me zbatimin e provizioneve nga Kodi i Balancit dhe Kodi Operativ, fillimisht për zbatimin e masave kufizuese në furnizim (reduktime) me rastin e shpalljes së situatës emergjente, respektivisht zbatimin e nenit 4.5 dhe nenit 5.4 të Udhëzimit Administrativ UA Nr.04/2017, të cilat do të duhej të vazhdonin deri në nxjerrjen e



vendimit nga Ministria e Ekonomisë për implementimin e planit të masave kufizuese në furnizim, pas aprovimit të rekomandimit të Komitetit Teknik Emergjent (KTE).

Për më tepër, në emailin e datës 27.09.2022 drejtuar ministrisë përkatëse, si dhe shkresën 2396 te datës 01.12.2022 drejtuar ministres së Ekonomisë, KOSTT konfirmon se në situatat emergjente të energjisë elektrike, KOSTT në cilësinë e operatorit të sistemit dhe të tregut angazhon të gjitha rezervat balancuese në disponim sipas dispozitave kontraktuale që i ka, mirëpo në situatën emergjente nuk mund të bëhet Shkyçja e Konsumit pa Vendim nga Ministria përkatëse (Neni 4.1 i Udhëzimit Administrativ nr. 04/2017), ku ka potencuar se vendimi i Ministrisë së Ekonomisë për aplikimin e shkyçjeve të konsumit në rastet e pamjaftueshmërisë së furnizimit është i domosdoshëm për balancimin e Zonës Rregulluese të KOSTT, në kuadër të Zonës Sinkrone të Evropës Kontinentale.

Prandaj ZRRE konsideron se pasi Ministria e Ekonomisë nuk ka nxjerrë vendim për kufizim të furnizimit me energji (reduktim), KOSTT do të duhej të zbatonte ligjin deri në nxjerrjen e këtij vendimi dhe mos të zbatoj kufizime në furnizim.

Sa i përket të gjeturës 3, ZRRE konsideron se sqarimet e dhëna nga KOSTT janë të qarta dhe mjaft mirë të argumentuara, ku mes tjerash KOSTT me përgjegjësi deklaron se ngarkon me obligime financiare vetëm palët tregtare që kane qenë në imbalance në atë periudhë kohore, saktësisht me pjesëmarrjen e tyre dhe në asnjë mënyrë me kosto shtesë për pjesën e imbalanceve të ndonjë pale tjetër tregtare, si dhe nga aspekti komercial ka bërë ndarjen energjisë së imbalanceve të veriut nga imbalance të tjera dhe pagesa për këtë energji nuk është bërë nga asnjë fond përveç atij të dedikuar për këtë qëllim nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Prandaj ZRRE plotësisht pajtohet me përgjigjet e KOSTT.

Në mbledhjen e Bordit të ZRRE-së të mbajtur më datë 27.01.2023, pas vlerësimit dhe analizimit të përgjigjeve në komentet e KOSTT, Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se duhet të kërkohen sqarime shtesë, në lidhje me aktivizimin e mFRR dhe kostot e shkaktuara për periudhën monitoruese.

ZRRE me datë 31.01.2023 i ka dërguar KOSTT kërkesën për të ofruar sqarime lidhur me aktivizimin e mFRR, ku me datë 06.02.2023 dhe më datë 16.02.2023 ZRRE ka pranuar raportet sqaruese.

Në raportet e dërguara, KOSTT për periudhën e raportimit, ka paraqitur sasinë e kapacitetit të kërkuar për mFRR, arsyet e refuzimit të ofrimit të shërbimit nga KESH si Palë Ofruese e Shërbimit, Kostot e devijimit për shkak të refuzimit të mFRR, si dhe Kostot e mFRR të realizuara sipas dakordimeve mujore.

Bazuar në të dhënat e dërguara nga KOSTT për periudhën raportuese, në disa raste Pala Ofruese e Shërbimit (POSH) ka dështuar të siguroj energjinë e deklaruar për aktivizimin e mFRR, me ç'rast janë shkaktuar devijime ndaj sistemit interkonektiv. Sipas Kontratës për Shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës mes palëve KOSTT dhe KESH si POSH, respektivisht neni 9, *në rast se POSH i mFRR dështon të aktivizoj në tërësi ose pjesërisht kapacitetin e deklaruar paraprakisht dhe të kërkuar nga KOSTT, atëherë POSH i mFRR i nënshtrohet përgjegjësisë së mekanizmit balancues në zonën LFC ku ai operon.*

Ashtu siç edhe është paraqitur në raportet e KOSTT lidhur me aktivizimin e mFRR si dhe sipas deklarimeve në takimin e mbajtur më 30.01.2023, në disa raste KOSTT nuk ka zbatuar nenin 9 të kontratës mFRR duke marrë përsipër edhe kostot e devijimeve të shkaktuara nga mosrespektimi i aktivizimit të mFRR nga ana e POSH. Për më tepër, KOSTT ka aktivizuar mFRR edhe në rastet kur nuk ka qenë e nevojshme, por është aktivizuar për nevojat e balancimit të sistemit.



Duhet të ceket se bazuar në Rregullën për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të OST dhe OT, në kuadër të të hyrave të lejuara ZRRE përcakton edhe Kostot e lejuara për shërbimet ndihmëse, pjesë e të cilave janë rezervat rregulluese automatike dhe manuale.

Nga këto që u thanë më lartë, ZRRE konstaton se: Mos zbatimi i nenit 9 të Kontratës për Shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës mes palëve KOSTT dhe KESH si Palë Ofruese e Shërbimit (POSH), ka ndikuar në kostot e operatorit KOSTT, e rrjedhimisht edhe për konsumatorin fundor, sepse një kosto të tillë për mFRR, ZRRE e aprovon me rastin e aprovimit të Të Hyrave të Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut konform nenit 12 të Rregullës për Të Hyrat e OST/OT-së.

Poashtu, aktivizimi i mFRR për nevoja të balancimit të sistemit është në kundërshtim me kërkesat ligjore respektivisht neni 13, par. 2 të Rregullës për Të Hyrat e OST/OT-së.

Shfrytëzimi i Fondit për energjinë e ripërtrishme (PER)

Të gjeturat e ZRRE-së:

1. Shfrytëzimi i mjeteve nga Fondi i BRE-ve për mbulimin e humbjeve katër komunat veriore të Kosovës është në kundërshtim me Rregullën për përcaktimin e të hyrave maksimale të OST/OT, respektivisht Neni 13, paragrafi 2.

2. Shfrytëzimi i mjeteve nga Fondi i BRE-ve për mbulimin e humbjeve në katër komunat veriore të Kosovës është në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës ku kërkohet që, deri në shpalljen e Aktgjykimit të formës së prerë, sipas Ligjit mbi Konfliktet Administrative, kosto e furnizimit me energji elektrike për katër komunat e veriut të Kosovës sipas Aktvendimit të Gjykatës nuk do të vazhdojë të mbulohet përmes tarifave të konsumatorëve fundor.

Përgjigje e KOSTT

1. KOSTT asnjëherë nuk ka përdorur mjetet e Fondit të BRE-ve për mbulimin e humbjeve në katër komunat veriore të Kosovës.

KOSTT, në përgjigjen e tij ka sqaruar në detaje se sa i përket deklaratës së KOSTT të datës 25.01.2022, në periudhën në fjalë, si pasojë e pagesave për mbulimin e humbjeve në katër komunat veriore të Kosovës, gjendja financiare e KOSTT ishte tejet e rënduar, ku detyrimet e pa paguara të KEDS dhe KESCO kishin arritur 47.9 milionë euro, ku 7.9 milionë ishin detyrime të papaguara ndaj Fondit të BRE-ve dhe këto detyrime mbuloheshin nga mjetet e KOSTT. Prandaj sipas KOSTT, kjo deklaratë ishte ilustrim i gjendjes së rënduar financiare, dhe në atë proces, në aspektin tarifor është kërkuar mbajtja e tepricës së Fondit nga viti paraprak duke u bazuar në mos pagesa të KEDS dhe KESCO dhe pamundësinë e KOSTT të mbështes më tutje Fondin e BRE-ve nga mjetet e veta, dhe kjo ka bërë që, deklarata të jetë keqkuptuar duke krijuar përshtypjen se KOSTT nga Fondi i BRE-ve ka shfrytëzuar mjete për mbulimin e humbjeve në komunat veriore, gjë që nuk ka ndodhur.

2. Që nga 1 dhjetori 2017, konsumatorët e Kosovës asnjëherë nuk kanë paguar për humbjet në komunat veriore të Kosovës përmes tarifave të KOSTT.

KOSTT, në përgjigjen e tij ka deklaruar se që nga shpallja e aktvendimit të Gjykatës, edhe pse obligimi për furnizim të pjesës veriore ka mbetur në fuqi, KOSTT asnjëherë nuk ka shfrytëzuar mjete tjera për



të mbuluar këto humbje, përveç mjeteve të lejuara sipas udhëzimeve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ku KOSTT udhëzohet që të shfrytëzoj mjete nga fitimet e mbajtura dhe të paguajë energjinë e prokuruar për këto humbje dhe pas pranimit të subvencionit prej 40 milionë euro nga Qeveria e Republikës së Kosovës për këtë qëllim.

Përgjigje e ZRRE-së

Sa i përket të gjeturave 1 dhe 2, ZRRE konsideron se sqarimet e dhëna nga KOSTT janë të qarta dhe mjaft mirë të argumentuara edhe me tabela financiare, ku mes tjerash KOSTT me përgjegjësi deklaron se asnjëherë nuk ka përdorur mjetet e Fondit të BRE-ve për mbulimin e humbjeve në katër komunat veriore të Kosovës dhe se që nga 1 dhjetori 2017, konsumatorët e Kosovës asnjëherë nuk kanë paguar për humbjet në komunat veriore të Kosovës përmes tarifave të KOSTT.

Prandaj ZRRE plotësisht pajtohet me përgjigjet e KOSTT.

Bazuar në konstatimet e cekura më lartë, I PROPOZOJMË Bordit të ZRRE-së, që pas vlerësimit dhe analizimit të materialit të bashkangjitur, të konstatoj se ka bazë të mjaftueshme për aplikim e dispozitave ndëshkimore të përcaktuara me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe dispozitat e Rregullit për Masat Administrative dhe Gjobat.

Kjo duhet të bëhet pas që ti jepet mundësia e fundit KOSTT SHA, ku ZRRE duhet të lëshoj NJOFTIM me shkrim me të cilin njofton palën, se mund të përgjigjen me shkrim për shkeljet e gjetura brenda katërmëdhjetë (14) ditësh pas dërgimit të njoftimit.